



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3810 Prot.

Roskovec, më 30.07 2020

VENDIM

NR 59.DATË 28.07.2020

“PËR NJË ULJE TË TARIFËS SË PASTRIMIT PËR SUBJEKTET PRIVATE TË CILËT U PREKËN NGA INFEKSIONI I SHKAKTUAR NGA COVID-19”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f , të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma a dhe c; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.711, date 29.10.2014, neni 18 dhe në mbështetje të Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive”; Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 193, date 20.03.2020, “Per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive”; Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 135, datë 09.03.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid-19” aktit normative nr.3 datë 15.03.2020 “ Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19” dhe aktit normative nr.4 datë 16.03.2020 “ Për disa shtesa në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1.1 Uljen e tarifës së pastrimit për subjektet të cilët nuk u lejuan të ushtronin aktivitetin e tyre ekonomike gjatë periudhës së mbylljes nga infeksioni i shkaktuar nga Covid – 19, **për aq ditë sa këto subjekte kanë qënë të mbyllur referuar** urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 193, datë 20.03.2020, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”
 - Për subjektet të cilët i kanë paguar taksat dhe tarifat për vitin 2020, kompensimi për uljen e tarifës së pastrimit sipas këtij vendimi, do të bëhet në tarifën e pastrimit të vitit 2021.
- 1.2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori i Biznesit për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.
- 1.3 Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.



KRYETAR
Kadri Hyska